

03 Nr. Br. 400-6870
14-05 20 26

Dragash - Dragaš

PJESA B: KONTRATA

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

KOMPANIA E SIGURIMEVE " PRISIG " SH.A., Rr.Eduard Lir, Ob.2-Lagj.Arbëria, PRISHTINË, 601173371 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

009-Sigurimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Dragashit-faza 2 me numër Identifikues 621-26-2569-2-3-6, dhe nr, te mbrendshem 621-2026-009-236.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë :**Sigurimi i automjeteve te administratës Komunale**

1.2 Kontrata hynë në fuqi : *menjëherë pas nënshkrimit te Kontrates 14.05.2026 dhe përfundon 12 muaj nga data e nënshkrimit te kontrates,ose deri me date 13.05.2027.*

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 2 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i *[kryerjes së shërbimeve]* do të jetë **-Dragash**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **1,191.04 €**; (një mij e njeqind e nentedhete e nje Euro e kater cent..

Në qmim duhet të përfshihet vetëm (Sigurimi i automjeteve) pa përfshirjen e taksave tjera.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do te behet me raport te nenshkruar nga Menaxheri i kontrates i cili eshte caktuar nga ZKA-ja: Kerim Latifi, (sipas listës së automjeteve) dhe fatura e dorezuar nga ana e Kompanise), e nenshkruar nga Veton Halili-mbikqyres i drejteperdrejte i menagjerit te kontrates.

[nëse kontrata përbëhet nga me shume se një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[shërbimeve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 **Garancioni per ekzekutim** do të mbetet valid për 13 muaj, ne vleren prej 10% te shumes totale ose 119.10 € deri me date 14.05.2027.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën komerciale-Prishtinë në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Fadil Sinani	Emri:	KOMPANIA E SIGURIMEVE "PRISIG" SH.A., Rr.Eduard Lir, Ob.2-Lagj.Arbëria, PRISHTINË, 601173371
Pozita:	U-D-zyrtar përgjegjës për prokurim	Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.04.2026.	Data:	14.05.2026.
Vula:		Vula:	

Lista e veturave pronë e KK Dragash - Tender 2026

Nr. ren.	Lloji i automjetit	Numri i shasisë	Numri i tabelave	Viti i prodhimit	CC(CM ³)	Çmimi me TVSH	
						TP	Çmimi me TVSH
1	TRAKTOR 4X4 DEUTZ-FAHR			2021	4000	TP	43.66
2	TRAKTOR 4X4 DEUTZ-FAHR			2020	4000	TP	43.66
3	TRAKTOR 4X4 DEUTZ-FAHR			2020	4000	TP	43.66
4	TRAKTOR 4X4 DEUTZ-FAHR			2021	4000	TP	43.66
5	TRAKTOR 4X4 DEUTZ-FAHR			2020	4000	TP	43.66
6	PEUGEOT PARTNER		04-891-K1	2023	1500	TP	156.89
7	CITROEN JUMPY		04-163-1P	2022	2000	TP	233.10
8	FIAT DUKATO		04-163-1P	2022	2300	TP	268.96
9	NISSAN PATROL-ZIARRIKËSIT-XHIP	JN1TESV61Z0562544	112-038-01	2008	2953	TP	313.79
TOTALI me TVSH							1,191.04 €

Verejtje: Shërbimet për sigurimin e automjeteve duke përfshirë marrjen e dokumentacionit dhe dergimin e tyre në QRA duhet t'i kryej Operatori Ekonomik!

Verejtje: Operatori Ekonomik duhet të ofroj çmimin vetëm në shërbimet e sigurimit të automjeteve, kurse shërbimet e kontrollit teknik dhe taksat t'jera i kryen vet Autoriteti kontraktues.





Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



- Kryetari i Komunës

02 Nr. 400/01-8988/26

Dt.13.05.2026

Dragash

Kryetari I Komunes,në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), si dhe ne pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës,si dhe Rregullave dhe Udhezuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr, A01, nxjerre:

V E N D I M

Caktohet menaxheri i kontrates dhe mbikqyresi në realizimin e kontrates për **009-Sigurimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Dragashit-faza 2** me numër Identifikues **621-26-2569-2-3-6**, dhe nr, të mbrendshëm 621-2026-009-236.

Kerim Latifi -caktohet menagjer I kontrates,

Veton Halili-Mbikqyres I drejteperdrejt I menagjerit te kontrates

Menaxheri I kontrates,obligohet që të hartojë një plan të menaxhimit të Kontrates,duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP, I cili duhet të nënshkruhet nga ana e të dy paleve(Menaxherit të Kontrates se AK dhe Menagjerit të Kontrates se OP) para inicimit të zbatimit të kontrates dhe një kopje të nënshkruar të planit për menaxhimin e kontrates do ta përcjellë tek departamenti I prokurimit,

1. Menagjeri I kontrates e menagjon kontraten deri në pranimin e plote të punëve të kerkuara-kontraktuara, respektivisht deri në përfundimin e kontrates.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit



Kryetari I Komunes:

Bexhet Xheladini

Vendimi u dërgohet:menagjerit të projektit,
Mbikqyresit të kontrates,
Zyres së Prokurimit,
Drejtorit të Drejtorisë përkatëse,
Arkivit të Komunes(kryetarit).